

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 202, date 11. 4. 2007

PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.547, DATE 9.8.2006. TE KESHILLIT TE MINISTRAVE, "PER KRIJIMIN E AGJENCISE KOMBETARE TE BURIMEVE NATYRORE"

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 10, te ligjit nr.9000, date 30.1.2003, "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave" , me propozimin e ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ne vendimin nr.547, date 9.8.2006, te behen keto shtesa dhe ndryshime:

1. Ne piken 3 shtohen nenpikat, si me poshte vijon:

". Sherben si organ i specializuar per ministrin pergjegjes per energjine, per problemet e strategjise dhe te politikës ne kete fushe;

. Promovon burimet e rinovueshme te energjise, si dhe propozon masa per rritjen e shfrytezimit te energjise ne ciklin energjetik;

. Harton dhe publikon bilancin energjetik vjetor, ne nivel kombetar dhe rajonal, ne perputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe te Agjencise Nderkombetare te Energjise;

. Monitoron kontratat koncesionare per hidrocentralet."

2. Ne piken 4, pas fjaleve "... Institutit te Studimeve dhe Projekttimeve te Mekanikes dhe Drurit..." shtohen "... dhe Agjencia Kombetare e Energjise." .

3. Kudo ne vendim fjala "hidroenergji" zevendesohet me "energji".

4. Pas pikes 10 shtohet pika 10/1, me kete permbajtje:

"10/01. Vendimet nr. 443, date 16.7.1998, "Per krijimin e Agjencise Kombetare te Energjise", dhe nr. 31 0, date 15.5.2003, "Per miratimin e struktures se nivelit te pagave te punonjesve te Agjencise Kombetare te Energjise", te Keshillit te Ministrave, shfuqizohen."

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

MINISTRI I EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGETIKES
GENC RULI